



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TIRANW

Nr. 991/Prot.

Tiranë, më 16.06.2026

**NJOFTIM**  
**MBI AFATET DHE PROCEDURAT E LËVIZJES PARALELE TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PSIKOSOCIAL PËR VITIN 2026**

Në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit nr. 313, datë 20.10.2020, i ndryshuar, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet arsimore parauniversitare dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit të punonjësit", më poshtë paraqiten afatet dhe procedurat për lëvizjen paralele të punonjësve të shërbimit psikosocial:

**Afatet e procedurës**

- Datë 16.06.2026 – 25.06.2026: Dërgohet me postë dosja dhe kërkesa e punonjësit me kontratë pa afat të caktuar.
- Datë 26.06.2026 – 30.06.2026: Bëhet vlerësimi i dosjeve.
- Datë 01.07.2026 – 03.07.2026: Afati për paraqitjen e ankimeve.
- Datë 08.07.2026: Shpallja e renditjes përfundimtare.
- Datë 01.09.2026: Ofrimi i vendeve vakante.

**Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:**

1. Përshkrimi i edukimit dhe karrierës profesionale – Jetëshkrimi (Curriculum Vitae), sipas Shtojcës 3 të Udhëzimit nr. 313, datë 20.10.2020, i ndryshuar (i detyrueshëm).
2. Kërkesë për lëvizje paralele (e detyrueshme).
3. Raport mjekoligjor i lëshuar brenda tre muajve të fundit (i detyrueshëm).
4. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës/diplomave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të paraqitet edhe akti i njohjes/njësimit nga Ministria e Arsimit (e detyrueshme).
5. Lista e notave e noterizuar për nivelin Bachelor dhe Master (e detyrueshme).
6. Leja për ushtrimin individual të profesionit (licenca), kopje e njehsuar me origjinalin (e detyrueshme).
7. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga aplikanti, sipas Shtojcës 4 të Udhëzimit nr. 313, datë 20.10.2020 (e detyrueshme).
8. Formulari i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, sipas Shtojcës 5 të Udhëzimit nr. 313, datë 20.10.2020 (e detyrueshme).
9. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomave të arsimit shtesë, listave të notave, si dhe certifikatave të gjuhëve të huaja ose kualifikimeve të tjera.
10. Fotokopje e noterizuar e librezës së punës (e detyrueshme).

11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale e lëshuar brenda tre muajve të fundit (e detyrueshme).
12. Dëshmi penaliteti (e detyrueshme).
13. Vërtetim nga institucioni ku ushtron detyrën, që konfirmon se nuk ka masë disiplinore në fuqi (i detyrueshëm).

Duke ju uruar suksese në këtë proces, ju falënderojmë për bashkëpunimin.

